

Dr. Qerim DALIPI

DEPËRTIMET DHE PUSHTIMET OSMANE DHE JETËSIMI I POLITIKËS VENEDIKASE NË ARBËRI (1392-1396)

Pas fitores së osmanëve ndaj Koalicionit ballkanik në Betejën e Kosovës (15. respektivisht 28 qershor 1389)¹ pozita e Arbërisë, përfshirë këtu edhe Principatën e Topiajve, në vitet në vijim, përballë invadimit osman u bë edhe më e vështirë. Kështu, paaftësitë e Gjergj Topisë (1388-1392) për ta mbrojtur Durrësin nga rreziku i vazhdueshëm osman, i rritën ambiciet e Venedikut për ta shtënë në dorë këtë qytet-port të rëndësishëm, që ndodhej në brigjet lindore të detit Adriatik. Më 8 mars 1392, Republika e Venedikut, nga frika e rënies së Durrësit në duart e osmanëve, e urdhëronte kapitenin e detit Adriatik që përmes lutjesh ta bindte sundimtarin e përmendur të dorëzonte kështjellën e këtij qyteti. Si këmbim për këtë, ai mund t'i premtojte Gjergjit që të banonte me familjen e tij në Durrës, duke ruajtur qeverisjen dhe të ardhurat e qytetit. Republika po ashtu e urdhëronte kapitenin në fjalë që të dërgonte balistarë, të cilët do të mbronin kështjellën e Durrësit nga sulmet osmane. Me këtë rast, ata duhej të shtreshin se e mbronin atë në emër të zotit të qytetit. Megjithatë, urdhëronte Republika, asnjë person tjetër nuk duhej të kishte pushtetin në Durrës, përveç saj.² Me këtë plan të kamufluar, Republika hidhte hapat e saj të fundit të sigurt për pushtimin e këtij qyteti, që do të bëhej pa trazira, çka do të zvogëlonte mundësinë e ballafaqimit të drejtpërdrejtë e në shkallë të gjerë me osmanët në rrafshin ushtarak.

Nëse plani i sipërpërmendur do të dështonte si rrjedhojë e kundërshtimit të Gjergj Topisë, Republika urdhëronte kapitenin e detit Adriatik që t'i premtojte atij dhe bashkëpunëtorëve të tij një provizion vjetor prej 500 dukatesh, të cilat duhej t'i ndanin midis veti. Po që se do të dështonte edhe kjo orvatje, atëherë kapiteni, urdhëronte Republika, duhej të gjente mënyrën për ta pushtuar kështjellën e Durrësit, përpara se ajo të binte në duart e osmanëve.³ Me këtë urdhër, Republika nxirrte në sipërfaqe synimet e saj të vërteta.

1 Për Betejën e Kosovës dhe pjesëmarrjen e shqiptarëve në të shih: Q. Dalipi, *Beteja e Kosovës (1389) dhe kontributi i shqiptarëve*, në: "Kosova", nr. 27, Prishtinë, 2005, f. 47-57; i njëjti punim edhe në: "Vizione", revistë e shkencave shoqërore, nr. 5, Shkup, 2005, f. 275-287.

2 *Acta Albaniae Veneta (saeculorum XII et XI)*, ed. J. Valentini, pars prima – tomus secundus, nr. 438, f. 139-141 (në tekstin e mëtejshëm: AAV, I 2); L. Malltezi, *Përpykjet dhe synimet e Venedikut për pushtimin e Durrësit (1386-1392)*, në: "Studime për epokën e Skënderbeut", II, Tiranë, 1989, f. 139-140, 3.44f, I 2, nr. 438, f. 141-142.

Në prill të vitit 1392, kështjella e Durrësit ndodhej në duart e kapitenit të detit Adriatik, të cilit ia kishte dorëzuar Gjergj Topia. Në dokumentin venedikas të 18 prillit të atij viti, përveç që përmendet se në Venedik ishte caktuar kështjellari i kështjellës së Durrësit, dhe se dorëzimi i saj ishte bërë nga zoti i Durrësit, nuk thuhet asgjë nëse ai dorëzim ishte bërë sipas një marrëveshjeje paraprake.⁴ Në mungesë të informacioneve burimore për çështjen e dorëzimit, është shprehur mendimi se zoti i Durrësit e kishte bërë atë në shkëmbim të provizionit vjetor të sipërpërmendur.⁵ Ndryshe nga kjo pikëpamje, ne konsiderojmë se dorëzimi ishte bërë pa kushte, ndoshta në momentet e fundit para se kështjella e Durrësit të binte në duart e osmanëve. Ky supozim konsiderojmë se mund të gjej mbështetje në faktin se dokumentet arkivore të asaj kohe flasin për një marrëveshje midis Gjergjit dhe Venedikut, vetëm pasi ky i fundit, siç është thënë më lart, e kishte shti nën zotërim kështjellën. Në këtë kuadër, në fillim të gushtit të vitit 1392, midis zotit të Durrësit dhe kapitenit të Detit Adriatik u arrit një marrëveshje, e cila më 18 të atij muaji u miratua në Senatin venedikas. Si dëshmitarë të saj morën pjesë përfaqësuesit e Gjergj Topisë, të cilët përveç ipeshkvit provenedikas Johanit, ishin qytetarë venedikas. Në mesin e tyre ishte edhe Filip Bareli, protovestiari (ministër i Financave) i Gjergjit. Në këtë mënyrë, në ditët e tij të fundit si zot i pavarur i Durrësit, Gjergj Topia rrethohej nga shumë venedikas. Sipas marrëveshjes së arritur, disa javë më parë në kështjellën e Durrësit, Gjergj Topia këtë kështjellë ua lëshonte venedikasve, ndërsa vetë pranonte të tërhiqej për të jetuar në qytetin e Durrësit bashkë me zyrtarët e tij, duke shfrytëzuar të ardhurat e qytetit. Arsyet për këtë veprim ishin: rreziku osman, shkatërrimi i viseve përreth dhe mbrojtja e qytetit dhe e paqes që do të siguroheshin nga Venediku. Kalimi i qytetit të Durrësit nën qeverisjen e venedikasve do të bëhej pas vdekjes së tij. Venediku premonte si shpërblim që ta ndihmonte Gjergjin në rimarrjen e territoreve të humbura nga osmanët dhe për të mposhtur përpjekjet e qytetarëve të Durrësit që do të çoheshin kundër sundimit të tij; vasalët e zotit të Durrësit, pas vdekjes së tij, mund të hynin e të dilnin në qytet pa u penguar nga pushteti venedikas i Durrësit. Në fund, princi do të shpërblehej për mirëdashjen e tij me një kredi prej 500 dukatesh, kurse flamuri i Republikës së Shën Markut do të ngrihej vetëm në kështjellën e Durrësit.⁶ Nga e gjithë kjo del se Gjergj Topia hyri nën vartësinë e

4 *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, collegerunt et digeserunt L. de Thallóczy-K. Jireček-E. de Sufflay, vol. II, Vindobonae, 1918, nr. 481, f. 120-121 (në tekstin e mëtejshmë: *A. Alb.*, II); AAV, I/2, nr. 445, f. 147-148; *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë*, vëll. II, përgatitur nga A. Buda-I. Zamputi-K. Frashëri-P. Pepo, Tiranë, 1962, nr. 132, f. 208-209 (në tekstin e mëtejshmë: *Burime të zgjedhura*).

5 L. Malltezi, *Përpjekjet dhe synimet e Venedikut ...*, f. 140.

6 AAV, I/2, nr. 448, 451, f. 151, 154-157; O. J. Schmitt, *Das venezianische Albanien (1392-1479)*, München, 2001, f. 229-230; i njëjti botim i përkthyer në shqip: *Arbëria Venedike (1392-1479)*, Tiranë, 2007, f. 229-230; L. Malltezi, *Përpjekjet dhe synimet e Venedikut ...*, f. 140-141.

Republikës deri në vdekjen e tij, para 26 tetorit të vitit 1392. Në të vërtetë, në këtë datë, Durrësi veç më ishte në duart e venedikasve, ndërsa Republika mori masa për vendosjen e pushtetit të saj në qytet.⁷ Në këtë mënyrë, si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e rrezikut osman dhe e paaftësisë së Gjergj Topisë për ta përballuar atë, Republika, më në fund, realizoi synimet e saj të kamotshme, pa asnjë pasojë në raport me bujarinë vendase dhe osmanët. Në të vërtetë, ajo e mori Durrësin pikërisht edhe me ndihmën e një pjese të asaj bujarie, së cilës, provizionin vjetor të vitit 1389, prej 30 dukatesh, tashti pas pushtimit të Durrësit, më 15 prill 1393 ia rriti në 40 dukate për secilin.⁸ Madje, tri ditë më pas më 18 prill 1393 Venediku vendosi t'u japë dhurata në stofra, në vlerë prej 355 dukatesh, nëntë fisnikëve arbërorë që kishin merita për kalimin e Durrësit nën zotërimin e Republikës.⁹ Por kjo nuk do të thotë se e gjithë bujaria arbërore e Principatës së Durrësit ishte vënë në mbështetje të dorëzimit të qytetit venedikasve. Njëra nga pikat e marrëveshjes së sipërpërmendur, ku Venediku premtojte se do të lejonte hyrje-daljet e vasalëve të Gjergj Topisë në Durrës, reflekton se megjithatë një pjesë tjetër e bujarisë në fjalë nuk ishte pajtuar me dorëzimin e qytetit.

Njësitet ushtarake osmane, përveç rrethinës së Durrësit po i binin kryq e tërthor edhe zotërimit të Gjergjit II Balsha (1385-1403). Në maj të atij viti, në Raguzë nga frika e sulmeve osmane u shqyrtua propozimi që të gjithë njerëzit e saj që ndodheshin në Shkodër të largoheshin nga atje. Konflikti midis Gjergjit II Balsha dhe osmanëve me sa duket, u ndez dhe mori përpjesëtime të mëdha midis muajve qershor dhe shtator të atij viti, kur bashkëshortja e Gjergjit II, Helena dy herë nga fundi i këtyre muajve kishte hequr dorë nga prirjet për t'u strehuar në Raguzë.¹⁰ Këtë hezitim ajo siç duket e kishte bërë duke pritur epilogun e konfliktit të sipërpërmendur, në të cilin Gjergji II rezistonte me mjaft sukses. Për këtë supozim të shprehur në mënyrë indirekte, hedhin dritë vetë zhvillimet që rezultuan me fundin e atij konflikti. Kështu, gjatë një beteje (me siguri në fund të verës së atij viti – Q. D.), osmanët e zunë rob Gjergjin II,¹¹ por ende nuk e kishin forcën e duhur ushtarake për të thyer në tërësi rezistencën e forcave të tjera të princit të robëruar. Për rrjedhojë, ata kushtëzuan lirimin e tij në shkëmbim të viseve që ia kërkonin.

Sipas një dokumenti venedikas të datës 7 tetor 1392, Pasha Jigit beu lirimin e Gjergjit II Balsha e kushtëzonte me dorëzimin e Ulqinit, të Shkodrës dhe të disa viseve të tjera. Në Senatin e Venedikut u rrit shqetësimi për këtë prirje të osmanëve, por jo dhe për fatin e princit të robëruar. Pasi u konstatua se do të ishte dëm i madh për Republikën e Venedikut dhe anijet

7. *A. Alb.*, II, nr. 486, f. 123; AAV, I 2, nr. 456, f. 162-163.

8. *A. Alb.*, II, nr. 496, f. 125-126; AAV, I 2, nr. 488, f. 191.

9. *A. Alb.*, II, nr. 497, f. 126-127; AAV, I 2, nr. 494, f. 195-1196.

10. Krah: *Историја Црне Горе*, II 2, Титоград, 1970, f. 57-58.

11. *A. Alb.*, II, nr. 485, f. 122; AAV, I 2, nr. 455, f. 160-162.

e saj që lundronin nëpër detin Adriatik, nëse viset e përmendura do të binin në duart e osmanëve, Senati mori vendim që të informojë komandantin e flotës së detit Adriatik, duke i dhënë instruksione për mënyrën e veprimit përballë rrezikut osman. Në të vërtetë, nga dokumenti, në mënyrë të tërthort, nënkuptohet se paraprakisht zonja e Gjergjit II, Helena i ishte drejtuar për ndihmë Republikës. Prandaj, urdhërohej komandanti i flotës të shkonte e të takohej me të në Ulqin, por të shtirej se këtë e bënte kokë më vete, respektivisht pa dijeninë e Republikës. Njëkohësisht, përcillej kërkesa që në qoftë se bashkëshorti i zonjës kishte arritur marrëveshje me osmanët sipas kushteve të sipërpërmendura, atëherë komandanti duhej ta bindte zonjën që të mbahej e të mbronte vendin dhe qytetet e saj, që të mos binin në duart e osmanëve sepse po të ndodhte kështu, shturja e principatës së saj do të ishte e paevitueshme. Për më tepër, dinakëria e Republikës erdhi në shprehje kur ajo paralelisht me urdhëresat e sipërpërmendura, përcillte dhe një urdhëresë tjetër, sipas së cilës nëse zonja do të kërkonte ndihmë, komandanti mund ta ndihmonte atë me 20-30 balistarë, por gjithnjë duke u shtirur se atë e bënte kokë më vete. Gjithashtu, porositej më tej komandanti që ta bindte zonjën që në asnjë mënyrë të mos i lëshonte viset e sipërpërmendura dhe duke bërë një rezistencë të tillë, të kishte besim ndaj Qeverisë venedikase.¹² Përderisa, në njërën anë në mungesë burimesh, nuk dihet se si rezultuan këto traktativa, në anën tjetër lind pyetja se përse Republika dinake fshihej kaq shumë në synimet e saj përballë osmanëve. Konsiderojmë se ajo këtë e bënte në një kohë kur po rrumbullakonte pushtimin e Durrësit, prandaj në rast se osmanët do t'u binin në gjurmë planeve të saj, vështirë se do të mund të evitohej konflikti i armatosur midis tyre dhe pa mëdyshje do të vihej në pikëpyetje ekzistenca e pushtetit venedikas në këtë qytet.

Rënia rob e Gjergjit II Balsha, i cili që më 10 mars 1392 gëzonte të drejtën e qytetarit venedikas,¹³ i mundësoi kundërshtarit dhe vasalit të tij të pabindur në Zetën e Epërme, Radiç Cërnojeviqit të realizonte planet e tij. Ky bujar, që kishte shti në dorë Buduën, shihej nga Republika e Venedikut si një aleat i ardhshëm i saj (në vend të Gjergjit II Balsha – Q. D.), sa që më 30 nëntor 1392, ajo i dha atij qytetarinë venedikase.¹⁴ Për rrjedhojë, pasi Radiçi aty nga fundi i vitit 1392 arriti të dëbojë Dukagjinët nga Lezha dhe rrethina e saj, proveditorët venedikas të Durrësit hynë menjëherë në bisedime me të, duke i kërkuar dorëzimin e qytetit Republikës e cila e konsideronte atë si “syryn e djathtë të Durrësit”. Megjithatë, Senati venedikas, në prill të vitit 1393 e refuzoi propozimin e kapitenit të Detit

12 AAV, I/2, nr. 455, f. 160-162; Ч. Мијатовић, *Балишићи – Скице за историју Зете*, në: “Гласник српског научног друштва”, књ. XLIX, Београд, 1881, f. 232-234.

13 A. Alb., II, nr. 478, f. 120; AAV, I/2, nr. 442, f. 144-145.

14 A. Alb., II, nr. 489, f. 124; AAV, I/2, nr. 462, f. 172.

Adriatik që të shkonte dhe t'i kërkonte Radiçit dorëzimin e Lezhës, si për shkak të frikës nga osmanët ashtu dhe për shkak të dyshimeve se një punë e tillë e rëndësishme mund të bëhej me pushtuesin e para pakohësh të qytetit. sesa më mirë me zotëruesit legjitim të tij – Dukagjinët. Këta të fundit, siç duket shfrytëzuan momentin kur Radiç Cërnojeviqi ishte i zënë me rrethimin e Kotorrit si dhe fortifikimin i osmanëve në Bunë, për të kthyer qytetin e humbur në duart e tyre. Në të vërtetë, zhvillimet rreth Lezhës janë të lidhura ngushtë me lirimin e Gjergjit II Balsha nga robëria osmane. që u bë në shkëmbim të qyteteve të tij: Shkodrës, Drishtit dhe Shën Shirgjit. Vendosija e pushtetit osman (në muajt e parë të vitit 1393 – Q. D.) në këto qytete, me në krye komandantin Shahinin, në fakt pamundësonte mbijetesën e pushtetit të Radiç Cërnojeviqit në Lezhë. Në rrethana të këtilla. Dukagjinët rimorën Lezhën dhe të frikësuar nga rënia e saj e mundshme në duart e osmanëve hynë në bisedime me Republikën. Në maj të vitit 1393 djemtë e Lekë Dukagjinit, Progoni dhe Tanushi, bashkë me të afërmit e tyre dhe kapiteni i Detit Adriatik, Johan Miami, të cilin e kishte dërguar Republika e Venedikut në Lezhë, nënshkruan marrëveshjen për dorëzimin e qytetit dhe të rrethinës së tij venedikasve. Sipas marrëveshjes. Dukagjinët do të merrnin një të tretën e të ardhurave të Lezhës, pasi që nga shumta e përgjithshme paraprakisht do të ndaheshin 800 dukate, të cilat do të harxhoheshin për “rojën dhe meremetimin” e qytetit dhe të pesë fshatrave, ku do të tërhiqeshin ata, me kusht që Progoni dhe Tanushi bashkë me kushërinjtë e tyre (djemtë Pavël Dukagjinit), në çdo kohë të zbatonin urdhrat e Qeverisë venedikase dhe prej fshatarëve të tyre të mos kërkonin kurrfarë detyrimi të jashtëzakonshëm, pa pëlqimin e administratës venedikase në Lezhë. Përveç kësaj, Dukagjinët obligoheshin të mos lejonin qëndrimin e dezertorëve venedikas dhe të kriminelëve të arratisur në fshatrat e tyre, të cilët do t'ua dorëzonin organeve të pushtetit venedikas ose do t'i vrisnin nëse kërkohesh një gjë e tillë. Me këto përkufizime të marrëveshjes, Dukagjinët u bënë nënshtetas venedikas, duke u lidhur edhe me një hua prej 600 dukatesh, që ua premtoi Venediku në emër të të ardhurave të ardhshme të Lezhës.¹⁵

15 И. Божић, *О Дукађинцима*, në: “Немирно поморје XV века”, редакција: Ф. Баришић и др., Београд, 1979, ф. 346-349; S. Pulaha, *Vështrim mbi historinë e Lezhës*, në: “Lissus”, Tiranë, 1967, f. 99; S. Daci, *Lezha nën sundimin e Venedikut*, në: “Studime për epokën e Skënderbeut”, II, Tiranë, 1989, f. 153-155. Konsiderohet se gjatë sundimit osman në krahinën e Shkodrës, i tërë pushteti ka qenë në duart e komandantit turk. Shahinit. Njëkohësisht, shihet si e mundshme që edhe Konstantin Balsha të ketë ushtruar aty ndonjë farë pushteti si princ vendas, ku do të ketë gëzuar të drejta të caktuara, midis të cilave edhe të drejtën e mbledhjes të të ardhurave nga dogana e Dejës (И. Божић, *Dominus rex Constantinus*, në: “Немирно поморје XV века”, редакција: Ф. Баришић и др., Београд, 1979, ф. 199-204). Aty nga fundi i vitit 1392, ose në fillim të vitit 1393, Konstantini i kërkoi Raguzës që t'i paguante tributin e Shën Dhimitrit, por ajo refuzoi (М. Шуша, *Вук Бранковић и састанак у Серу*, në: “Зборник радова Византолошког института”, XLV, Београд, 2008, ф. 258.

Gjergji II Balsha u tërhoq në Ulqin dhe si vasal i sulltanit u detyrua t'i paguante atij tribut vjetor. Atë e mblidhte në zotërimin e tij dukat për oxhak, por nuk dihet në sa arrinte sasia e tij.¹⁶ Megjithatë, sundimtari arbëror edhe pse në pozitë shumë të vështirë, nuk hoqi dorë nga prirjet për të ripërtërirë principatën e tij, që ishte cunuar bukur shumë (përfshinte Ulqinin dhe Tivarin). Ai menjëherë ua ndaloi të nënshtruarve të tij që të tregtonin me banorët e Lezhës dhe protestoi në Venedik për çështjen e pushtimit të Lezhës, duke kërkuar largimin e menjëhershëm të venedikasve nga qyteti. Këtë kërkesë Gjergji II e mbështeti në faktin se Lezha më parë i kishte takuar atij dhe paraardhësve të tij. Mirëpo, Republika e Shën Markut nuk ia vuri fort veshin kësaj proteste. Ajo në korrik të vitit 1393 u përgjigj në mënyrë cinike, duke deklaruar se qytetin nuk e kishte marrë nga ai, por nga armiku i tij (Radiç Černojeviqi), nga i cili nuk do të shqetësohej më; nëse Gjergji II do të kishte marrëdhënie të mira me Republikën, pushteti venedikas i Lezhës do të mbështetej në vetë atë dhe nëse qyteti do ishte në duart e Gjergjit II, ai patjetër do të detyrohej t'ua dorëzonte atë osmanëve.¹⁷ Me këtë qëndrim, Republika kaloi në pozita të hapura armiqësore ndaj Balshajve. Prandaj, për dallim nga pretendimet se “venedikasit më shumë dëshironin që territoret arbërore dhe zetase të mbeteshin në duart e feudalëve vendas, të cilëve do t'u ofronin vetëm ndihmë ushtarake (kundër osmanëve – Q. D.), me çka do të siguronin lehtësime në monopolin tregtar”,¹⁸ ne konsiderojmë se megjithatë Republika angazhohej për zgjerimin e zotërimeve të saj, por gjithmonë duke i peshuar mirë punët. Në këtë kuadër, pa dyshim bëjnë pjesë edhe zhvillimet rreth çështjes së kështjellës së Krujës, të cilën, siç do të shohim më poshtë, Republika e konsideronte si pjesë të zotërimeve të veta.

Pas vdekjes së Gjergj Topisë i cili nuk pati fëmijë, pushtetin e trashëgoi motra e tij, Helena. Ajo ishte e martuar me venedikasin Mark Barbadikun. Në fakt, çifti sundonte në Krujë,¹⁹ që ishte pikë e rëndësishme strategjike si për osmanët ashtu edhe për venedikasit. Përderisa të parëve do t'u shërbente si bazë për të intensifikuar sulmet ndaj Durrësit, të dytëve do t'u vlente si pararojë për t'i penguar ato. Prandaj, Republika e Shën Markut nuk u vonua të urdhëronte proveditorët e saj, që i dërgonte në Durrës (nëntor 1392), të kërkonin nga Helena dhe bashkëshorti i saj që të njihnin sovranitetin venedikas, pasi Kruja sipas dogjës së Venedikut, hynte juridikisht në “përkatësitë e Durrësit” dhe për këtë arsye i përkiste shtetit

16 *Историја Црне Горе*, II/2, f. 58.

17 И. Божић, *О Дукађиници*, 349; A. Alb., II, nr. 504, f. 130; AAV, I/2, nr. 506, f. 209-211.

18 В. Нграбрak, *Privreda Albanije u XIV i XV veku*, në: “Simpozium për Skënderbeun – Simpozium Skenderbegu”, Prishtinë - Priština, 1969, f. 69.

19 M. Shuffaj, *Serbët dhe shqiptarët - Historia e shqiptarëve të veriut*, Tiranë, 2001, f. 134.

venedikas, në bazë të marrëveshjes së arritur më parë me Gjergj Topinë.²⁰ Pretendimet venedikase në këtë drejtim u treguan frytdhënëse. Në gusht të vitit 1393, çifti i sipërpërmendur i njihte shtetit venedikas të drejtën sovraane mbi kështjellën e Krujës.²¹

Në fillim të vitit 1394, Gjergji II Balsha, përkundër refuzimit të sipërpërmendur venedikas për çështjen e Lezhës, vendosi megjithatë të hynte në traktativa me Venedikun kundër osmanëve. Marrja e këtij vendimi mund të supozohet se u bë nën ndikimin e shembullit të Dukagjinëve, që ishte shumë më domethënëse, sesa pozita e Gjergjit II në raport me osmanët, të cilëve u paguante haraç dhe ishte në rrezik të vazhdueshëm nga to. Në këtë drejtim, Gjergji II u tregua i kujdesshëm. Në janar të vitit 1394 u paraqit në Venedik i dërguari i tij ipeshkvi i Shkodrës i cili në emër të zotërisë së vet i propozoi Republikës dorëzimin e viseve që ishin nën pushtetin osman "Shkodrën dhe disa vende në brendi të vendit", me kusht që venedikasit të bënin atë që do të ishte e përshtatshme dhe e drejtë. Mirëpo, Senati i Venedikut më 3 shkurtit 1394 refuzoi ofertën e Gjergjit II, duke u arsyetuar se ato vise ishin larg nga deti dhe se mund t'i sillnin Republikës më shumë dëme sesa dobi. Po ashtu, u potencua se Shkodra ndodhej në duart e osmanëve, prandaj ishte e vështirë që ajo të merrej pa turp,²² duke aluduar në evitimin e acarimit të marrëdhënieve me osmanët të cilët do të kundërshtonin një pushtim të tillë. Përderisa Republika tregohej mjaft e matur në marrjen e vendimeve, propozimi i Gjergjit II tregon se ai ato treva i konsideronte të vetat, dhe se kalimi i tyre në duart e saj do të bëhej sipas kushteve të caktuara.

Në maj të vitit 1394, Kruja më nuk ishte nën vartësinë e Republikës së Venedikut. Ky ndryshim, siç duket ishte rezultat i mosbesimit midis çiftit të Krujës, që sundonte në kështjellën shkëmbore me një pagë vjetore prej 100 dukatesh dhe Republikës që pasqyrohet përmes marrëveshjes midis tyre, sipas së cilës nëse çifti do ta shkelte atë detyrohej të paguante 10 000 lira dëmshpërblim. Në fakt, e gjithë kjo, me siguri, ishte rrjedhojë e qëndrimit antivenedikas të Helenë Topisë, për shkak të pushtimit venedikas të Durrësit,²³ si dhe të trysnisë osmane. Për këtë të fundit sinjalizon njoftimi i bajlit venedikas të Durrësit, që i bënte Republikës, në maj të atij viti për situatën e vështirë që kalonte qyteti nga sulmet osmane. Në rrethana të këtilla, Kruja detyrimisht nuk mund të përjashtohej nga sulmet e tyre, kur dihet se ajo vlente si pararojë e qytetit buzë detit. Prandaj, vetë shkuarja e Mark Barbadikut për t'iu përlulur Bajazitit (Pashës Jigit Beut), përpara 21

20 L. Malltezi, *Rreth historisë së kështjellës së Krujës dhe zonës së saj në vitet 1392-1415*, në: "Studime historike", nr. 2, Tiranë, 1989, f. 160.

21 *A. Alb.*, II, nr. 508, f. 131; *AAV*, I 2, nr. 515, f. 221-222.

22 *A.H.*, I 2, nr. 530, f. 235; 4, *Mijarobith*, pun. cit., f. 238.

23 O. J. Schmitt, *Das venezianische ...* f. 234; I njëjti, *Arbëria ...* f. 233-234; M. Shuflaj, *Serbët dhe shqiptarët ...* f. 135.

majit 1394²⁴ dëshmon se ai ishte ballafaquar nga afër me rreziqet osmane, kundrejt të cilave ndoshta nuk kishte organizuar ndonjë qëndresë të vendosur, vetëm për t'u larguar nga vartësia venedikase ndaj së cilës çifti i Krujës kishte pakënaqësi. Me këtë veprim çifti siguroi sundimin në Krujë, gjë që u konveniente edhe osmanëve të cilët ende nuk e kishin forcën e duhur për t'i konkretizuar inkursionet e tyre me pushtime, prandaj përmes këtij vasali do të synojnë t'ua marrin venedikasve Durrësin. Në këtë drejtim sipas një dokumenti venedikas, të datës 24 korrik të atij viti, Mark Barbadiku ishte kthyer nga Pasha Jigit Beu me mandat për të pushtuar të gjithë krahinën deri në Durrës.²⁵ Kjo i shkaktoi shqetësime të mëdha Republikës, saqë ende mbante shpresa për ta bindur ish-vasalin e saj të kthehej në besnikërinë venedikase, qoftë edhe përmes kërcënimit. Ajo më 24 korrik shpalli masën për paraqitjen e tij në Venedik brenda tre muajve për të dhënë llogari. Mirëpo, vasali osman nuk u frikësua nga kërcënimi. Ai e ndjente veten aq të fuqishëm saqë siç njoftonte bajli i Durrësit më 6 shtator 1394 i kishte parashtruar atij kushte shumë të mëdha, të cilat nuk mund të pranoheshin në asnjë mënyrë. Në rrethana të këtilla, Republika patjetër duhej të priste skadimin e ultimatumit të dhënë, e pastaj të merrte veprime shtesë kundër tij. Kështu, ajo më 6 nëntor e shpalli Markun rebel të shtetit venedikas dhe vendosi t'i jepte bajlit të Durrësit 4 000 dukate nga të cilët 3 000 për t'i përdorur për pushtimin e kështjellës së Krujës dhe 1 000 për kapjen e tij.²⁶ Tashmë duke qenë në armiqësi të plotë midis tyre, Mark Barbadiku këputi të gjitha kontaktet me Republikën dhe filloi të quhej "Zot i Krujës". Ai ndaloi ardhjen dhe kalimin e karvanëve të mallrave që zbrisnin nga viset e brendshme të vendit për në Durrës dhe filloi plaçkitjet mbi territorin venedikas të këtij qyteti. Marku, madje sulmoi oborrin e Filip Barelit mbi Kepin e Rodonit e plaçkiti atë, zuri rob gruan e tij dhe u martua me të. Nga ana tjetër, në një përpjekje të armatosur Mark Barbadiku u thye nga Niketë Topia, aleat i venedikasve.²⁷ Në kohën kur Republika e Shën Markut po dështonte në përpjekjet për ta rikthyer Mark Barabadikun nën vartësinë e saj, qyteti i Durrësit dhe rrethinat e tij, para 28 shtatorit 1394, po trazoheshin nga sulmet e njësiteve osmane të

24 A. Alb., II, nr. 518; f. 135; AAV, I/2, nr. 546, f. 246. Në pranverë të vitit 1394 osmanët pushtuan disa fshatra të Dukagjinëve përreth Lezhës, por nuk arritën t'i mbanin për shumë kohë. Dukagjinët u kundërpërgjigjën shpejt dhe brenda një kohe shumë të shkurtër i rimorën fshatrat e humbura, të cilat më pas, gjatë viteve 1395-1396, i mori Gjergji II Balsha (S. Daci, *pun. cit.*, f. 155).

25 A. Alb., II, nr. 522, f. 135; AAV, I/2, nr. 559, f. 254.

26 L. Maltezi, *Rreth historisë së kështjellës së Krujës ...*, f. 161-162.

27 Dokumenti që hedh dritë për këto ngjarje (d.m.th. atëherë kur Mark Barbadiku ishte zot i Krujës) është i datës 20 dhjetor 1401. Ai përmban akuzat shtetërore në procesin gjyqësor për dënimin e Mark Barbadikut, të zhvilluar në Venedik (A. Alb., II, nr. 680, f. 202-203; *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV 1400-1405*, I, përgatitur nga I. Zamputi-L. Maltezi, Tiranë, 1987, nr. 169, f. 260-263). Në fitoren e Niketë Topisë kishte kontribuar edhe Helenë Topia (që iu hakmor ish-burrit të saj për tradhtinë që i bëri - Q. D.). Më pas, Mark Barbadiku u strehua te Gjergji II Balsha dhe u paraqit vullnetarisht në gjykatën e Venedikut më 1401 (M. Shuftaj, v. c., f. 135; *Историја Црне Горе*, II/2, f. 60).

drejtuara nga Shahini i Shkodrës dhe vasali i tij Dhimitër Jonima. Ata zunë shumë robër në rrethinat e Durrësit, ndërsa Republika u kundërpërgjigj me shpalljen e një shume prej 300 dukatesh për kokën e Dhimitrit. Mirëpo, Republika duke dashur t'i ruante marrëdhëniet e mira me qeveritarin e Shkodrës Shahinin dhe përgjithësisht me shtetin osman, u tregua mjaft e matur ndaj tij. Më 28 shtator të atij viti, ajo urdhëronte zëvendëskapitenin e Detit Adriatik të shtonte në Durrës dhe të konstatonte nëse bajli i atjeshëm kishte arritur t'i lironte venedikasit e zënë rob kundrejt pagesës. Po të mos kishte ndodhur një gjë e tillë, atëherë zëvendëskapiteni duhej të lundronte për në Shën Shirgj, prej nga do të dërgonte përfaqësuesin e tij në Shkodër për t'i kërkuar Shahinit lirinë e qytetarëve venedikas.²⁸ Përderisa Gjergji II Balsha ishte gati të fillonte luftën kundër pushtetit osman të Shkodrës²⁹ (shtator 1394), rivaliteti osmano-venedikas për mbisundim në Arbëri e kishte zbehur që më parë pozicionin e Konstantin Balshës, për të përfituar nga ajo situatë si vasal osman. Gjatë gjysmës së parë të vitit 1393 marrëdhëniet e tij me osmanët ishin acaruar aq shumë saqë ai në qershor të atij viti përmes zonjës së Vlorës Komnenës (Komita), i kërkonte leje Republikës që pasi të fortifikonte pesë ose gjashtë viset e tij, të vendosej me familjen e tij në zotërimet e saj në Eube ose në Korfuz për një periudhë katërvjeçare.³⁰ Përkundër faktit se një gjë e tillë nuk ndodhi, konsiderojmë se është e rëndësishme të zbulohen motivet që e detyruan Konstantinin të largohej nga vasaliteti osman e të kërkojë strehim në zotërimet e Republikës. Konsiderojmë se kjo ndodhi ngaqë pushtimi i Durrësit në fund të vitit 1392 nga venedikasit dhe hyrja e Gjergjit II Balsha nën vasalitetin osman në fillim të vitit 1393 i pamundësonin Konstantinin të pushtonte Durrësin dhe të zotëronte qendra të rëndësishme si vasal osman, sikurse Gjergji II. Në këtë mënyrë ai privohej si personalitet i rëndësishëm në sytë e osmanëve, prandaj zotërimi i pesë ose gjashtë viseve nuk e arsyetonte të qëndruarit vasal të osmanëve të cilët në çdo kohë mund t'ia merrnin

28 *A. Alb.*, II, nr. 526, f. 137-138; AAV, I 2, nr. 567, 570, f. 263-264, 266; O. J. Schmitt, *Das venezianische ...*, f. 236; I njëjti. *Arbëria ...*, f. 236; M. Спремин, *Свети Спр под млетачком влашћу (1396-1479)*, në: "Зборник Филозофског факултета", књига VII-1, Београд, 1963, f. 297.

29 *Историја српског народа*, II, Београд, 1982, f. 54.

30 *A. Alb.*, II, nr. 503, f. 130; AAV, I 2, nr. 501, f. 206-207; И. Божић, *Неверство Вука Бранковића*, në: "О кнезу Лазару", научни скуп у Крушевцу (1971), Београд, 1975, f. 235. Me sa duket, zonja e Vlorës, Komnena, e kërcënuar nga rreziku osman, krahas përcjelljes së kërkesës për strehim të Konstantin Balshës, përmes përfaqësuesit të saj, i propozonte Republikës së Venedikut dorëzimin e Vlorës dhe të Kaninës, Mirëpo, Senati venedikas e refuzoi këtë ofertë dhe i lejoi asaj të rekrutonte 25 shigjetarë në territorin venedikas (Himarë – Q. D.), procedurë e cila do të kryhej nën mbikëqyrjen e pushtetit venedikas (*A. Alb.*, II, nr. 503, f. 130; AAV, I 2, nr. 501, f. 206-207; M. Антоновић, *Област Валоне и Канине под српском влашћу (1343-1417)*, në: "Зборник Филозофског факултета", серија А: историјске науке, Београд, 1994, f. 166). Madje, Republika përcolli edhe këtë përgjigje: "Duaam [...] që miqtë tanë të rrinë në sundimet e tyre dhe [...] vendet e tyre më mirë t'i mbrojnë ata sesa ne" (O. J. Schmitt, *Das venezianische ...*, f. 235; I njëjti. *Arbëria ...*, f. 234-235). Sa u përket pesë ose gjashtë viseve që i zotëronte Konstantin Balsha, në mesin e tyre bënin pjesë edhe Deja me doganë dhe kështjella e Shasit (*Историја Црне Горе*, II/2, f. 62). Këto vise, ai, me siguri, i kishte shti në dorë me ndihmën e pushtetit osman të Shkodrës (1393-1395).

ato. Megjithatë, praktika tregoi se ai edhe më tej mbeti i rëndësishëm për osmanët në përpjekjet e tyre pushtuese në Arbëri. Në këtë drejtim, në fund të vitit 1394 ose në fillim të vitit 1395 kështjella e Krujës ndodhej në duart e Konstantin Balshës.³¹ Këtë pushtim, sipas të gjitha gjasave ai e bëri me ndihmën e osmanëve dhe me miratimin e Helenë Topisë, që u martua me të.³² Me ardhjen e Konstantin Balshës në krye të kështjellës së Krujës komplikohesh shumë çështja e sundimit të venedikasve në Durrës, si dhe shtrirja e pushtetit të tyre në kështjellën shkëmbore. Në shkurt të vitit 1395 ata vendosën të dërgonin pranë Konstantinit një përfaqësues të vetin që dinte greqisht për t'i kërkuar që t'i kthente shtetit venedikas kështjellën apo të paktën që ta bindte zotin e saj të mos qëndronte më nën pushtetin e osmanëve.³³ Mirëpo, përpjekjet e venedikasve nuk dhanë rezultate. Konstantini as që mendoi të hynte në bisedime me ta. Ai u mbeti besnik osmanëve dhe me forcat e tij i shoqëroi ata në betejën e Rovinit (17 maj 1395), ku u ndesh ushtria e Bajazitit I me ushtrinë e Sigismundit dhe të princit të Vllahisë, Johan Mirçes. Fitorja u takoi hungarezëve.³⁴

Pjesëmarrja e Konstantin Balshës në Betejën e Rovinit, që me siguri u shoqërua me forca osmane me në krye Shahinin, krijoi në Arbëri për një periudhë të shkurtër një zbrastëritje pushteti, rrethanë të cilën kundërshtarët e osmanëve e shfrytëzuan me vendosmëri. Gjergji II Balsha i vari shpresat në mbështetjen e Republikës së Venedikut, e cila në këtë drejtim dha dritë të gjelbër. Më 11 maj 1395, atij iu dha qytetaria venedikase. Madje, Republika vendosi të intervenonte ushtarakisht në Arbëri. Me pëlqim të Senatit u armatos një ushtarak italian, i cili do të drejtonte sulmet ndaj Krujës. E trembur nga epërsia venedikase, Raguzat përkrahte njerëz proosmanë, si nënën e Konstantin Balshës, Teodorën (emri i murgeshës Ksenia) dhe përpiquej të ngulfate pozicionin e aleatit të Venedikut, Gjergjit II Balsha duke mos pranuar ta furnizonte atë me drithë (mars 1395).³⁵

Më 22 qershor 1395, bajli venedikas i Durrësit i raportonte qendrës se përpjekjet e tij për t'ia marrë Konstantinit kështjellën e Krujës kishin përfunduar pa sukses. Pa dyshim, këto dështime të venedikasve ishin rrjedhojë e kundërshtimit të Helenë Topisë që atëherë qeveriste me

31 Në dokumentin venedikas, të datës 14 shkurt 1395, thuhet se kështjella e Krujës ndodhej në duart e Konstantin Balshës (*A. Alb.*, II, nr. 529, f. 139; AAV, I/2, nr. 574, f. 269-270). Ka gjasë që ai ta ketë pushtuar Krujën që nga fundi i vitit 1394, kur Mark Barbadiku pat pësuar disfatë nga Niketë Topia.

32 M. Shuffaj, v. c., f. 135. Në një dokument venedikas, të datës 8 qershor 1395, thuhet se Helena ua kishte dhënë Krujën osmanëve (*A. Alb.*, II, nr. 535, f. 141; AAV, I/2, nr. 582, f. 281; *Burime të zgjedhura*, nr. 134, f. 211-212) d.m.th. vasalit të tyre, Konstantin Balshës.

33 L. Mallezi, *Rreth historisë së kështjellës së Krujës ...*, f. 164.

34 M. Динић, *Област Бранковића*, në: "Српске земље у срењем веку", приредио С. Ђирковић, Београд, 1978, f. 156; И. Божић, *Dominus rex Constantinus*, f. 202; *Историја српског народа*, II, f. 51, 54; etj.

35 O. J. Schmitt, *Das venezianische ...*, f. 236; I njëjti, *Arbëria ...*, f. 237; И. Божић, *Dominus rex Constantinus*, f. 202.

kështjellën e Krujës dhe rrethinën e saj, pasi siç dihet bashkëshorti i saj në atë kohë nuk ndodhej aty. Megjithatë, Republika nuk pushoi së hartuari plane për realizimin e synimit të saj. Një tregtar venedikas, që hynte e dilte në Krujë, angazhohej që ta shtinte në dorë kështjellën pa shpenzime për shtetin. Për çdo eventualitet, në korrik të atij viti Republika njoftonte bajlin e Durrësit se do të dërgonte pranë tij personin e lartpërmendur për të konsultuar me të planin e vet si dhe të shqyrtonte të gjitha variantet e mundshme të pushtimit të kështjellës duke shpenzuar për këtë qëllim deri më 3 000 dukate ari.³⁶

Në fund të shtatorit ose në gjysmën e parë të tetorit të vitit 1395 Gjergji II Balsha, më në fund arriti t'ua marrë osmanëve ish-viset e tij: Shkodrën, Drishtin dhe Shën Shirgjin, ndërsa Konstantin Balshës Dejën dhe Shasin. Çlirimi i këtyre viseve u bë në një moment të përshtatëm, pra atëherë kur repartet e garnizoneve osmane në to ishin në numër të vogël, për shkaqe tashti më të njohura. Për këtë sukses të madh, Gjergji II vendosi të festonte. Ky qe një rast i mirë që raguzanët të ndryshonin qëndrimin e tyre ndaj Gjergjit II, për dallim nga rasti i përmendur më lart. Ata tashti, duke parë këtë fuqizim të tij, vendosën që për shkak të interesave të tyre tregtare në Arbërinë Veriore dhe në Zetë, të afrohen me të. Gjatë një dasme në shtëpinë e Balshajve, raguzanët dërguan një dërgatë me blatime të pasura.³⁷ Nga Raguzë u kthye djali i Gjergjit II, Balsha. Më pas, barkat raguzane prunë edhe përfaqësuesit e banit kroato-dalmatin. Ndërsa, noteri venedikas i Lezhës me kërkesë të Gjergjit II në kishën e qytetit në Ulqin shkroi autorizimin për tre përfaqësues që duhej të zhvillonin bisedime me Republikën e Venedikut, për t'i dorëzuar asaj vise të sipërpërmendura.³⁸ Këto prirje të Gjergjit II nuk ishin pa vend. Ai që kishte përjetuar më parë robërinë osmane, e dinte se ballafaqimi eventual me kundërpërgjigjen osmane do të ishte i papërbalueshëm, aq më tepër kur i duhej më shumë kohë për të rimarrë veten nga konflikti i porsapërfunduar.

Një gjendje frike e pasigurie mbretëronte edhe në Arbërinë Jugore. Rrumbullakimi i pushtimit të Thesalisë më 1393,³⁹ u mundësonte

36 Krah.: L. Malltezi, *Rreth historisë së kështjellës së Krujës* ..., f. 164.

37 *Историја Црне Горе*, II 2, f. 62; O. J. Schmitt, *Das venezianische ...*, f. 236; I njëjti, *Arbëria* ..., f. 236. Ka të ngjarë që Konstantin Balsha, i ndodhur nën presionin e Gjergjit II Balsha, përpigjej të tërhiqte në anën e tij Raguzën, së cilës i botohej për besnikëri, duke i dhënë një privilegj për tregti të lirë nëpër vise të tij. Dokumenti u hartua më 13 nëntor 1395 në Ular pranë Shkodrës (*Законски споменици српских држава средњег века*, прикупио и уредио С. Новаковић, Београд, 1912, nr. LXIX, f. 210-211; *Monumenta serbica, spectantia historiam Serbiae, Bosnae, Ragusii* (Institut für Slavistik der Universität Graz), edidit Fr. Miklosich, Graz, 1964, nr. CCXVI, f. 228; *A. Alb.*, II, nr. 543, f. 145), ndoshta njëri nga fshatrat e fundit që e mbante ende në duart e tij.

38 *Историја Црне Горе*, II 2, f. 62. Autorizimi u shkrua më 10 nëntor 1395 (A. Alb., II, nr. 542, f. 145; *Listine o odnošajin ismedju Južnoga Slavenstva i Mletačke republike*, knjiga IV, objavio Š. Ljubić, Zagreb, 1874, nr. D, f. 350 - në tekstin e mëtejshëm: *Listine*, IV).

39 В. Ферјанчић, *Тесалија у XIII и XIV веку*, Београд, 1974, f. 280-281.

osmanëve që të shpeshtonin inkursionet e tyre ndaj viseve fqinje. Në këtë drejtim, me sa duket njësitet osmane po u binin kryq e tërthor viseve në prapashpinë të zotërimit të zonjës së Vlorës, Komnenës (1385-1395/6) dhe nuk përjashtohet mundësia që ata të kenë trazuar edhe viset periferike të zotërimit të saj. Në ekzistimin e kësaj gjendjeje na sugjeron oferta e Komnenës për t'i dorëzuar zotërimin e vet Republikës së Shën Markut. Në të vërtetë, para datës 5 tetor 1395 ajo përmes peshkopit të saj i propozoi Republikës dorëzimin e Vlorës, të Kaninës, të Pirgut dhe të Himarës (domethënë kjo e fundit sërish ishte nën sovranitetin e zonjës). Dorëzimi do të bëhej kundrejt një dëmshpërblimi vjetor prej 7 000 dukatesh, shumë të cilën ajo mendonte ta shpenzonte bashkë me vajzën e saj me rastin e vendosjes në njërin nga zotërimet venedikase. Këtë shumë Republika do ta siguronte nga të ardhurat e zotërimit të Komnenës, të cilat mbërrinin deri më 9 000 dukate në vit. Megjithatë, Republika më 5 tetor iu përgjigj peshkopit se e kishte të qartë qëllimin e mirë të zonjës së tij ndaj nderit venedikas, për ç'arsye edhe e falënderonte atë, por ato vise nuk mund të merreshin në dorëzim pa pasur një informacion të detajuar. Siç mund të shihet, Republika tregojë mjaft e matur për çështjen e përmendur. Ajo merrte në konsideratë të gjitha rrethanat, duke nënkuptuar edhe rrezikun osman. Në këtë kuadër, Republika urdhëronte kapitenin e Detit Adriatik të informohej për çdo gjë, si për kufijtë e viseve të lartpërmendura dhe të të ardhurave të tyre, ashtu edhe për shpenzimet që ajo duhej t'i bënte për t'i ndihmuar ato (kundër rrezikut osman - Q. D.). Ndryçimi i këtyre rrethanave, siç thuhet, do të ishte i dobishëm për të dyja palët.⁴⁰ Me këtë qasje, Republika hezitoi të mbajë barrën e harxhimeve për strehimin e Komnenës dhe të vajzës së saj si dhe u tregua e kujdesshme ndaj rrezikut osman. Prandaj ajo nuk e pranoi ofertën e zonjës, ndoshta edhe për shkak se priste fundin e konfliktit në përfundim e sipër të Gjergjit II Balsha me osmanët. Si do që të jetë, Republika iu qas me përkushtim të veçantë propozimit të këtij të fundit.

Të dërguarit e Gjergjit II, me sa duket në fillim të dhjetorit të vitit 1395 mbërritën në Venedik dhe paraqitën kërkesën e shkruar në formë memorandumit. Qeveria venedikase potenconte se ata ishin shumë këmbëngulës dhe kërkonin që t'u jepej përgjigje e shpejtë për kërkesat e tyre. Megjithatë Senati venedikas e diskutoi këtë çështje më 30 dhjetor. Me këtë rast u vlerësua se nëse ato vise do të binin sërish në duart e osmanëve, atëherë kjo do të sillte pasoja të rënda. Prandaj, ndaj kësaj çështjeje duhej të veprohej me maturi dhe mençuri. Një grup senatorësh mbajtën

40 A. Alb., II, nr. 540, f. 144; AAV, I/2, nr. 598, f. 294-295; *Burime të zgjedhura*, nr. 135, f. 213-214.

qëndrimin se për shkak të respektimit të marrëveshjeve ndërkombëtare (të Zarës dhe të Torinos – Q. D.) dhe të marrëveshjeve me Bajazitin I, kërkesat e Gjergjit II duhej të refuzoheshin. Ata propozuan që princi të falënderohej për ofertën e paraqitur dhe të porositet që të mos largohej nga ato vise e t'i ruante për vete, sepse së shpejti Republika do të shihte mundësinë për të bërë diçka. Me këtë formulim të fundit, ndoshta aludohej në kryqëzatën që po përgatisnin vendet evropiane kundër osmanëve. Ndërsa, grupi tjetër i senatorëve u shprehën se duhej të fillonin menjëherë bisedimet me të dërguarit e princit, por vendimi të mos merrej menjëherë, përderisa Senati nuk miratonte kushtet më të favorshme. Një senator i këtij grupi madje u shpreh se duhej të pranohej oferta e Gjergjit II, por me kusht që të mos i paguhej atij provizion vjetor. Megjithatë, Senati konkludoi se për arsye të një "shkaku të sigurt" duhej të merreshin informata shtesë, në bazë të së cilave do të merrej vendimi përfundimtar.⁴¹ Me këtë vendim traktativat midis palëve mbeteshin të hapura. Republika shfaqti interes për ofertën e Gjergjit II dhe nuk e paraqiti si shumë problematike çështjen e provizionit (në mënyrë të tërthortë nënkuptohet nga formulimi i sipërpërmendur - miratimi i kushteve të favorshme). Përderisa për provizionin lihej vend për t'u diskutuar, Republika shqetësimin më të madh e kishte për respektimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, shkelja e të cilave do t'i sillte asaj telashe serioze.

Rrethana krejtësisht të tjera mbretëronin në Arbërinë Jugore. Mëkëmbësi i pushtetit osman në Thesali (nga viti 1394), komandanti i zgjuar Evrenozi⁴² (Vranezi) që para gjashtë vitesh kishte kryer një inkursion ndaj zotërimeve të Gjin Bua Shpatës, tashti në janar të vitit 1396 i shoqëruar edhe nga komandanti i dalluar Jashi (Jaksi), u drejtua kundër Gjin Zenebishit. "Kronika Janinës" nuk jep të dhëna të hollësishme për këtë inkursion, por nga një shprehje e saj lakonike "edhe pasi kaluan andej, i priti Shpata në pozicionin e Driskut dhe ranë në luftë"⁴³ mund të

41 JAJ, I, 2, nr. 603, 604, 605, f. 299-2302; 4, Мижатовић, *пун. cit.*, f. 240-241.

42 K. Јиречек, *Историја Срба (до 1537)*, друга свеска, Београд, 1923, f. 99 (në tekstin e mëtejme: K. Јиречек, *Историја Срба*, II). Shënimet që gjenden në regjistrin e vitit 835 sipas hixhrit, respektivisht të 9 shtatorit 1431, për trevat e Korçës dhe të Përmetit, tregojnë se në ato vise administrata dhe pushteti osman ishin vendosur qysh në kohën e sundimit të sulltan Bajazitit I, të paktën që nga viti 1392 (S. Pulaha, *Luftërat shqiptaro-turke në veprat e kronistëve dhe historianëve osmanë të shekujve XI-XVII*, në: "Studime për epokën e Skënderbeut", III, Tiranë, 1989, f. 411), ose 1394 (H. Inalçik, *Krahina e Krutës dhe e Dibrits rreth vitit 1467*, në: "Konferenca e dytë e studimeve albanologjike", me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, Tiranë, 12-18 janar 1968, Tiranë, 1969, f. 183). Konsiderojmë se më shumë gjasa ka që kjo të ketë ndodhur pas pushtimit të Thesalisë (1393), domethënë në vitin 1394, atëherë kur osmanët rrumbullakuan vendosjen pushtetit të tyre në atë krahinë (Krah.: K. Јиречек, *Историја Срба*, II, f. 99) dhe pushtuan për herë të dytë Selanikun, në prill të vitit 1394 (*Historia e Perandorisë Osmane*, nën drejtimin e R. Mantranit, Tiranë, 2004, f. 56). Rrjedhimisht, osmanëve u hapën dyert për të pushtuar vise të tjera në perëndim të Thesalisë, siç qenë ato të Korçës e të Përmetit, që rezultuan me vendosjen e pushtetit osman në ato anë.

43 *Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë (shek. X-XV)*, përgatitur për botim nga K. Bozhori-F. Liço, Tiranë, 1975, f. 249 (në tekstin e mëtejme: *Burime tregimtare*). Jashi ishte djali i Timurtash

mendohet se forcat e Gjin Zenebshit ishin tërhequr nga zotërimi i tyre dhe, për t'u bërë ballë forcave osmane, në një pozicion të përshtatshëm siç ishte Drisku, ishin bashkuar me forcat e Gjin Bua Shpatës, të cilat bashkërisht këtë radhë duhej të kishin qenë në një numër më të madh se çdoherë tjetër. Kronika në fjalë, duke evituar përshkrimin e hollësishëm të betejës, jep vetëm përfundimin e saj. Kështu, pasi të krishterët (arbrit) i therën ismailitët (osmanët) i ndoqën ata deri te Faneromeni (kishë në perëndim të Janinës – Q. D.), kurse komandantët osmanë ikën me rreth 300 veta.⁴⁴ Kjo fitore dëshmoi se po të bashkoheshin si në këtë rast edhe princat e tjerë arbërorë, rezultatet nuk do të mungonin. Mirëpo, pikërisht mungesa e këtij uniteti e kishte detyruar Gjergjin II Balsha që për të sfiduar rrezikun osman, të vazhdonte traktativat me Republikën e Venedikut të filluara qysh në dhjetor të vitit 1395.

Në janar dhe në shkurt të vitit 1396, përfaqësuesit e Gjergjit II në Venedik po diskutonin modalitetet me autoritetet politike vendase për kalimin e krahinës së Shkodrës nën zotërimin venedikas. Ndërkohë Republika u kërkoi funksionarëve të pushtetit të saj në Durrës, që ta njoftonin nëse Arbëria Veriore konsiderohej Arbëri ose Dalmaci me qëllim që për realizimin e synimeve venedikase në krahinën e Shkodrës, të mos i kërkoheshin leje Hungarisë.⁴⁵ Megjithatë, këto dilema siç duket u tejkaluan pasi që i dërguari bizantin Manuel Filantropin, para 1 marsit 1396 shkoi në Venedik duke u përpjekur që ta tërhiqte atë në aleancë me Hungarinë kundër osmanëve. Edhe pse venedikasit e shinin me mosbesim gjithçka që ndërmori mbreti hungarez Sigismundi, megjithatë u pajtuan që në mënyrë indirekte t'i përmbanin kryqtarët.⁴⁶ Pra, Republika e Venedikut si aleate e mbretit hungarez, nuk e kishte vështirë të fitonte pajtueshmërinë hungareze për çështjen e krahinës së Shkodrës.

Në muajt e parë të vitit 1396, Gjergji II, përmes dërgatave të tij i kishte parashtruar shtetit venedikas kushtet për dorëzimin e krahinës së Shkodrës: ai dhe pasardhësit e tij të trajtoheshin si qytetarë besnikë të Republikës së Shën Markut; Republika të mos ia merrte atij krahinën që i mbetej; të ngrihej aty flamuri venedikas; kushdo që do të donte të largohej nga zotërimi i tij, nuk duhej të pranohej në viset që po ia lëshonte Republikës; në qoftë se dikush tentonte t'ia merrte zotërimin që mbante, venedikasit duhej ta ndihmonin atë me njerëzit e armatosur të krahinës që po ua lëshonte atyre; të merrte si provizion prej Republikës të paktën 1 000 dukate në vit përgjithmonë si subvencion për të dhe trashëgimtarët

Pashës (Dh. Shuteriqi, *Moti i madh – Përmbledhje shënimesh e dokumentesh për historinë shqiptare të viteve 1379-1479*, përgatitur për botim nga Z. Prela-Shuteriqi, Tiranë, 2006, nr. 68, f. 25).

⁴⁴ *Burime tregimtare*, f. 249.

⁴⁵ G. Valentini, *Shënime mbi regjimin e vendqëndrimeve veneciane në Shqipëri në shekullin XIV dhe XV*, në: "Vepra III", përgatitur nga K. Krisafi etj., Tiranë, 2006, f. 139-149.

⁴⁶ И. Пурин, *Сумрак Византије – Време Јована Палеолога (1392-1448)*, Београд, 1984, f. 87, shën. 78.

e tij; dhe nëse babai i tij, ai vetë ose xhaxhai i tij, Balsha i kishin marrë ndonjë gjë ose i kishin shkaktuar ndonjë dëm ndonjë venedikasi atij të mos i kërkohej asgjë për to.⁴⁷ Përmes këtyre kushteve të paraqitura bie në sy fakti se Gjergji II, përderisa në njërin anë kërkonte siguri të plotë nga Republika, që të mos e sulmonte zotërimin që i mbetej në anën tjetër nëpërmjet kërkesës për sigurimin e subvencionit dhe të ndihmës së njerëzve të armatosur nga krahina e Shkodrës (që do t'i kalonte Republikës) për të përballuar sulmet e feudalëve vendas, por pse jo edhe ato osmane, la vend që të kuptohet se ai synonte të mbetej aty bashkësundues me venedikasin.

Traktativat diplomatike⁴⁸ zgjatën deri më 14 prill 1396, kur edhe u nënshkrua akti i marrëveshjes, në të cilin me disa modifikime kishin zënë vend kërkesat e Gjergjit II. Përjashtim bënte kërkesa që në fakt parashihte rekrutimin e ushtarëve në krahinën e Shkodrës, që Gjergji II po ua lëshonte venedikasve. Me mospërfshirjen e kësaj kërkesë, u mënjanuan bukur shumë pretendimet e tij për të qenë bashkësundues. Njëkohësisht, mospërmendja e masave që do të duhej të ndërmerreshin, në rast të sulmeve osmane (nga frika e tyre iu bë ky dorëzim Republikës së Venedikut), tregoi se Republika dinake nuk ishte e gatshme të ekspozohej publikisht kundër osmanëve, në një kohë kur i shikonte me skepticizëm përgatitjet e Sigismundit kundër tyre. Ajo, madje bënte përpjekje për ta pajtuar perandorin bizantin Manuelein II me Bajazitin I, dhe me këtë rast t'i përmirësonte edhe vetë marrëdhëniet me osmanët.⁴⁹ Këtë qëndrim ndaj osmanëve, Republika e mbajti edhe me

47 AAF, I 2, nr. 608, 611, f. 304-306, 309-314; P. Bogdani, *Lufta e Principatës së Balshajve dhe e sundimtarëve të tjerë shqiptarë kundër Venedikut në 20 vjetët e parë të shek. XI* (punim disertacioni, depozituar në Arkivin e Institutit të Historisë, Tiranë), Tiranë, 1984, f. 73-74.

48 Më 8 shkurt 1396, Senati i Venedikut formuloi projekt marrëveshjen, që duhej të ishte pranuar nga Gjergji II Balsha, pasi më 21 mars u zgjodhën rektorët që duhej të shkonin në Shkodër (G. Valentini, *pun. cit.*, f. 140), për të marrë pushtetin.

49 II. Бурић, v. c., f. 48. Marrëveshjes i parapriu një arsyetim i Gjergjit II Balsha, që përcillej përmes përfaqësuesve të tij. Ata deklaruan se zoti i tyre ishte në dijeni të planeve të Bajazitit (Pashës Jigit beut), i cili mendonte t'i ripushtonte viset e krahinës së Shkodrës. Sipas tyre, nëse do të ndodhte kjo, atëherë osmanët mund të pushtonin edhe viset e tjera të Gjergjit II dhe të zotërinjve të tjerë. Prandaj, meqë zoti i tyre nuk mund t'u rezistonte osmanëve, ai kishte vendosur që viset e asaj krahine t'ia dorëzonte Republikës, ndërsa vetë të sundonte i sigurt në zotërimin që i mbetej. Sipas marrëveshjes së nënshkruar midis përfaqësuesve të Gjergjit II Balsha dhe Republikës së Shën Markut, në Venedik, kjo e fundit morri qytetin e Shkodrës me kështjellën e tij me të gjitha të ardhurat, doganat, taksat qoftë në Shirq, qoftë në vende të tjera që i përkisnin atij qyteti, së bashku me liqenin dhe ishujt që ishin në të. Venediku morri edhe qytetin e Drishtit me kështjellën dhe përkatësitë e tij, si dhe kështjellën e Shasit me doganën e Dejës me të gjitha fshatrat, doganat, të ardhurat, përkatësitë dhe taksat. Gjergji II, sipas kësaj marrëveshjeje, mbante për vete dhe për trashëgimtarët e tij qytetin e Ulqinit me gjithë distriktin e tij, si dhe qytetin e Tivarit me të gjithë krahinën. Lumi i Bunës do të ishte i lirë për lundrim (domethënë zonë e çmilitarizuar) dhe mbetej si kufi natyror midis tij dhe Republikës së Venedikut. Si shpërblim Republika pranonte ta trajtonte atë dhe trashëgimtarët e tij si qytetarë dhe fisnikë venedikas, duke u dhënë të drejtën e pjesëmarrjes në Këshillin e Madh të Venedikut, si anëtarë të tij. Veç kësaj, Republika pranonte t'u jepte Gjergjit II dhe trashëgimtarëve të tij 1 000 dukate në vit nga të ardhurat që ajo do të nxirrte nga Shkodra, si dhe premtonte të mos i përkrahte kundërshtarët e Gjergjit II dhe të mos ia merrte atij atë pjesë të zotërimit që i mbetej nga principata e mëparshme (AAF, I 2, nr. 628, f. 331-336; Ч. Мижатовић, *pun. cit.*, f. 247-251; M. Сипевућ, *Савезу Срп* ..., f. 297-298; L. Mallezi, *Shkaqet e luftës së Balshës III kundër Republikës së Venedikut në 20 vjetët e parë të shek. XV*, në: "Studime për epokën e Skënderbeut", II, Tiranë, 1989, f. 181-182, shën. 19; I njëjti, L. Mallezi, *Qytetet e*

rastin e Dejës dhe të Shasit, qendra të cilat përkundër faktit se duhej t'i kalonin asaj sipas marrëveshjes, ajo nuk e bëri këtë meqë atje në vitin 1396 si vasal i osmanëve sundonte fisniku arbëror Kojë Zaharia.⁵⁰ Në rrethana të këtilla, Gjergji II vështirë se mund të fitonte ndihmën e venedikase në rast të rishfaqjes së rrezikut osman. Thënë ndryshe, Republika mund ta shfrytëzonte rrezikun osman për të realizuar synimet e saj ndaj viseve të zotit të dobësuar.

Dorëzimi i krahinës së Shkodrës Republikës së Venedikut,⁵¹ realisht e çlironte Gjergjin II Balsha nga ankthi i rishfaqjes së rrezikut osman, ngase në një rast të tillë osmanët paraprakisht do të insistonin në rikthimin e krahinës së humbur të Shkodrës. Për rrjedhojë ata do të ballafaqeshin me venedikasit.⁵² Një lehtësim tjetër për të ishte përqendrimi i presionit osman në Kosovë ndaj vasalit të pabindur të sulltanit, Vuk Brankoviçit.⁵³ Rrethanat e këtilla i mundësonin Gjergjit II Balsha të kishte një farë lirie veprimi për të konsoliduar zotërimin e mbetur e për ta zgjeruar atë me viset që kishin rënë në duart e bujarëve rivalë.⁵⁴ Në këtë drejtim, ai më 25 prill

bregdetit shqiptar gjatë sundimit venedikas (1392-1478), Tiranë, 1988, f. 61-62).

50 M. Shuftaj, v. c., f. 136; И. Божић, *О Дукађинима*, f. 350.

51 Më 31 maj 1396, Gjergji II njoftonte Republikën se u kishte dorëzuar proveditorëve venedikas qytetin e Shkodrës dhe krahinën e tij (AAV, I/2, nr. 631, f. 7).

52 Në diskutimet e zhvilluara në Senat, më 8 shkurt, për disa nga kushtet e parashtuara të Gjergjit II (se Republika nuk do të rrezikonte zotërimin që do t'i mbetej atij, dhe nëse dikush do ta sulmonte atë, ai të mund të mbrohej me ndihmën e njerëzve të tij nga krahina që do t'ua lëshonte venedikasve), i ngarkuari për këtë çështje konfirmoi se dogja pranonte të mos e sulmonte zotërimin që do t'i mbetej zotit të përmendur, por nuk pranonte ta mbronte atë me nënshtetas venedikas, nëse dikush do ta sulmonte. Më tej ai shtoi se Republika nuk e kishte traditë të jepte premtime të tilla, dhe se Gjergji II nuk duhej të frikësohej, sepse kur venedikasit do t'i merrnin ato vise, osmanët më as që do të mendonin ta sulmonin vendin e tij, ndërsa zotërinjtë e tjerë, fqinj të tij, për shkak të respektit ndaj shtetit venedikas, do të rrinin në kufijtë e tyre dhe do të jetonin në paqe me të. Mirëpo, nëse ndodhte diçka midis tyre, theksonite i ngarkuari, venedikasit premtorin se në çdo kohë do të ndërmjetësonin për rivendosjen e paqes (Ч. Мијатовић, *рун. cit.*, f. 246-247).

53 Me sa duket, në mars të vitit 1396, osmanët ia morën Vuk Brankoviçit Prishtinën, ndërsa në gjysmën e dytë të atij viti tërë zotërimet e tij. Pas triumfit të osmanëve në Nikopojë (shtator 1396), Bajaziti I ndërmori ekspeditë ndëshkuese ndaj Hungarisë dhe vendeve sllave. Me këtë rast, Vuk Brankoviç ra në duart e sulltanit dhe vdiq në robëri më 6 tetor 1397. Pjesën më të madhe të zotërimeve të tij osmanët ua dhanë trashëgimtarëve të vasalit të tyre, Stefan Lazareviçit. E veja e Vukut, Mara me djemtë e saj, mori një zotërim të vogël (me siguri bashkinat familjare në Drenicë) sa për të jetuar. Pasardhësit e tij mundën t'i kthejnë disa vise nga zotërimet e humbura vetëm para betejës së Angorës, kur i blenë nga sulltani (М. Динић, *рун. cit.*, f. 159-165; И. Божић, *Неверство Вука Бранковића*, f. 235; *Историја Српског народа*, II, f. 56, 58, 63).

54 Radiç Černojeviçiqi e sulmoi Kotorrin më 1393 dhe më 1395 (И. Божић, *Село Богдашићи у средњем веку*, në: "Немирно поморје XV века", редакција: Ф. Баришић и др., Београд, 1979, f. 42). Ai e detyroi qytetin t'i paguante tribut, sipas marrëveshjes së nënshkruar në fund të vitit 1395. Megjithatë, frika nga sulmet e tij ekzistonte edhe në fillim të vitit 1396. Përfaqësuesi i Kotorrit, në janar të vitit 1396, i kërkoi Republikës që ta merrte qytetin në dorëzim, sepse në të kundërtën qytetarët e tij patjetër "duhej t'u nënshtroheshin ose arbërve, ose serbëve, ose osmanëve". Kotorrasit me termin arbër nënkuptonin Černojeviçët, kurse me termin serbë zotërinjtë boshnjakë Hraniçë-Kosaqët (*Историја Црне Горе*, II/2, f. 64-65), respektivisht Sandal Hraniçin. Republika e Venedikut, më 20 prill 1396, me rastin e dërgimit të fisnikëve të saj për të marrë zotërimet e Shkodrës dhe të Drishtit nga Gjergji II, i urdhëroi ata që të afroreshin me Radiç Černojeviçin, qytetar venedikas dhe shumë i fuqishëm, që plaçkiste me njerëzit e tij në ato anë (AAV, I/2, nr. 628, f. 342). Për sulmin e Radiç Černojeviçit ndaj Kotorrit (1395) dhe aktiviteteve diplomatike rreth këtij rasti shih edhe te: С. Мијушковић, *Неколико података о Радичу Црнојевићу на*

1396 korri fitore ndaj fisnikut partikularist Radiç Cërnojeviqit, duke arritur të nënshtrojë një pjesë të territorit të tij⁵⁵ në Zetën e Epërme. Mirëpo, fitorja e arritur u zbeh përballë fisnikut boshnjak Sandal Hraniqit (nip prej vëllai i Vlatko Vukoviqit) i cili po zhvillonte një politikë të pavarur në Zetë, duke pushtuar disa vise të saj. Sandali, në prill ose në maj të atij viti duke shfrytëzuar konfliktin midis palëve të sipërpërmendura dhe pakënaqësinë e zetasve dhe të arbërve, që kishin ndaj zotërisë së tyre feudal. Gjergjit I, me ndihmën e këtyre të fundit arriti të pushtojë Buduën, duke u quajtur “zot i Buduës dhe Zetës” (Budue et Zente dominus). Përmes këtyre sukseseve, zotëria boshnjak e vinte Gjergjin II në pozitë shumë të vështirë, në një kohë kur ky i fundit kishte hedhur hapat e parë drejt zgjerimit të zotërimit të tij. Prandaj, armiqësitë midis tyre ishin të paevitueshme. Gjergji II (ndoshta i lodhur nga lufta kundër Cërnojeviqëve – Q. D.) vendosi të kërkonte ndërmjetësimin e Raguzës, mirëpo kjo refuzoi.⁵⁶ Megjithatë, aty nga fundi i vitit 1396. Gjergji II realizoi një takim të rëndësishëm me mbretin hungarez Sigismundin, i cili e nderoi me titullin “princ i Arbërisë” (princeps Albaniae) dhe i dha të drejtën e sundimit mbi ishujt dalmatë: Korçulë, Lesinë⁵⁷ (ose Hvar - Q. D.) dhe Braç.⁵⁸ Rrjedhimisht, kjo ishte një përkrahje e fuqishme për princin e dobësuar përballë politikës së Venedikut dhe rrezikut osman.

Vendosja e pushtetit venedikas në krahinën e Shkodrës konsiderojmë se ishte një goditje e rëndë për autoritetet e pushtetit osman të Shkupit. Ato patjetër duhej të gjenin mënyrën për të mbijetuar në Arbërinë Veriore, kur

основу архивске грађе из Државног архива у Котору, në: “Историски записи”, орган Историског друштва Народне Републике Црне Горе, година V, књига VIII, свеска 4-12, Цетиње, 1952, f. 312-315, 55. Lajmi mbi fitoren e Gjergjit II Balsha ndaj Radiç Cërnojeviqit mbërriti në Senatin e venedikas më 31 maj 1396 (A. Alb., II, nr. 557; AAV, I 3, nr. 635, f. 7; G. Gelcich, *La Zedda e la dinastia dei Balšići*, Spalato, 1899, f. 190). Luftime të ashpra ndërmjet Gjergjit II Balsha dhe Radiç Cërnojeviqit ishin zhvilluar në krahinat e Ulqinit dhe të Tivarit, me ç’rast ishin dëmtuar kishat e Ulqinit dhe të Tivarit. Po ashtu kishte pësuar dëmtime edhe manastiri i Shën Marisë së Rotecit në Spiç, që i takonte distriktit të Tivarit (M. Стремнић, *Ратачка опатија код Бара*, në: “Зборник Филозофског факултета”, књига VIII 1. Београд, 1964, f. 191, 195).

56 Sandal Hraniqi u paraqit në skenën politike pas vdekjes së mbretit boshnjak Tvërko (1391), kur shteti boshnjak u copëzua në shumë zotërimet feudale të pavarura. Aktiviteti i tij mund të përcillet më mirë nga viti 1395. Ky zotëri zhvilloi një politikë të pavarur ndaj Zetës, duke arritur të ketë nën sundimin e tij pjesën veriore të Grykës së Kotorrit dhe viset perëndimore të Malit të Zi të sotëm. Pas disfatës së Cërnojeviqëve nga Gergji II, ndoshta Sandali e shtriu përkohësisht pushtetin e tij në viset malore të tyre. Përndryshe zotëria boshnjak, aty nga fillimi i vitit 1397, e shtriu pushtetin e tij edhe në Kotorr, i cili i premtoi pagimin e një tributi vjetor nga të ardhurat e qytetit. Kotorri mbeti nën sundimin e tij deri më 1403 (С. Ђирковић, *Историја средњовековне босанске државе*, Београд, 1964, f. 178-178; *Историја Црне Горе*, II 2, f. 65-66; М. Маловић-Ђукић, *Которски културал солски у средњем веку*, në: “Зборник радова Византолошког института”, XL1, Београд, 2004, f. 464). Në fund të nëntorit të vitit 1396, Raguzia nuk pranoi kërkesën e Gjergjit II për t’u dërguar një anije, përmes së cilës zonja e tij, Helena, synonte të shkonte pikërisht në këtë qytet për t’u takuar me Sandalin (A. Alb., II, nr. 576, f. 160 dhe shënimi) me qëllim që të zgjidhni mosmarrëveshjet.

57 G. Gelcich, v. c. 196.

58 Mbreti hungarez Sigismundi e takoi personalisht Gjergjin II Balsha në dhjetor 1396, kur ai, pas disfatës në Nikopojë, me anijet venedikase kthehej në Hungari, përmes Raguzës dhe Splitit (*Историја Црнеке о народа*, II, 58).

dihet se atje nuk kishin asnjë kështjellë drejtpërsëdrejti nën sundimin e tyre. Disa kështjella në duart e vasalëve të tyre (Shasi, Deja dhe Kruja), logjikisht mund të kishin fatin e qyteteve të sipërpërmendura që i mori Republika. Prandaj, pushtimi i Krujës shkëmbore, prej nga mund të ndërmerreshin ekspedita ndëshkuese ndaj viseve të Arbërisë Jugore dhe Veriore, do të ishte një kërcënim serioz për qytetet që i zotëronte Republika, në radhë të parë për Durrësin e pastaj për Lezhën e më gjerë, do t'u mundësonte osmanëve të shpresonin në ripërtëritjen e pushtimeve të tyre. Një gjë e tillë nuk ishte edhe e vështirë të realizohej, kur dihet se burimet e kohës të vitit 1396 nuk e përmendin Konstantin Balshën për zot të Krujës, që nënkupton se ai nuk ndodhej aty. Konsiderojmë se nga ky këndvështrim duhet parë pushtimin osman të Krujës nga Prebistiti, që kishte ndodhur përpara 25 shtatorit 1396.⁵⁹ Me këtë rast, sipas burimeve të mëvonshme osmane, autoritetet e pushtetit osman të Rumelisë ua falën banorëve të Krujës pagesën e taksave.⁶⁰ Ky hap mund të shihet si përpjekje për të mos ngjallur tek ata revoltën kundër sundimit osman, në një kohë kur pozitat e tij në Arbëri ishin shumë të dobëta. Në të vërtetë Prebistiti ia kishte vënë syrin Durrësit dhe tentonte ta pushtonte atë. Kjo shkaktoi kundërpërgjigjen e Republikës së Shën Markut, e cila më 25 shtator urdhëroi dy funksionarët e saj që po i dërgonte me detyrë në Durrës, të shihnin mundësinë e marrjes me forcë të kështjellës së Krujës, me të drejtë që të shpenzonin për këtë qëllim aq sa ishte autorizuar të shpenzonte (3000 dukate – Q. D.) që më parë bajli i Durrësit për pushtimin e saj.⁶¹ Përkundër prirjeve të këtilla të Republikës, dokumentet nuk kanë regjistruar asgjë mbi zhvillimet e mëtejme rreth kësaj çështjeje.

Njëkohësisht me pushtimin e Krujës, forca të tjera osmane po u binin kryq e tërthorë viseve të Arbërisë Jugore. Sundimtari i ri i Vlorës, Mërksha Zharkoviq, me siguri, i frikësuar nga rreziku i tyre, i ofroi Republikës së Venedikut dorëzimin e zotërimit të tij, po me të njëjtat kushte sikurse një vit më parë (tetor 1395) që i kishte propozuar vjehrra e tij Komnena që ndërkohë kishte vdekur. Këtë radhë, në kuadër të viseve të ofruara bënte pjesë edhe Berati. Megjithatë, Senati i Venedikut më 19 shtator 1396 konstatoi se kjo çështje kërkonte maturi, dhe se kapiteni i Detit Adriatik duhej të mblidhte informacione shtesë për të.⁶² Natyrisht se qasja e këtillë e Republikës ishte e ndërlikuar me frikën e reagimit osman, në një kohë kur ajo nuk e dinte se si mund të ishte ai rreth viseve që tashmë ishin nën sundimin e saj. Prandaj, ajo nuk dëshironte të rrezikonte edhe më shumë në këtë drejtim.

59 *A. Alb.*, II, nr. 572, f. 156; *AAV*, I/3, nr. 654, f. 29-30.

60 *Krah.*: H. Inalçik, *pun. cit.*, f. 183.

61 *A. Alb.*, II, nr. 572, f. 156-157; *AAV*, I/3, nr. 654, 29-31; L. Malltezi, *Rreth historisë së kështjellës së Krujës ...*, f. 165.

62 *A. Alb.*, nr. 570, f. 155; *AAV*, I/3, nr. 651, f. 26-27.

Dr. Qerim DALIPI

SUMMARY

**THE OTTOMAN INVASION AND THE VENETIAN POLICY
IN ALBANIA (1392-1396)**

Following the victory in Kosova, Ottomans intensified their raids into Arbëria, including the harbor town of Durres. Venetian Republic, fearing that the city could fall in Ottoman hands increased its presences and activities to get hold of the harbor. To achieve this goal, Venetians established contacts with Gjergj Topia and local nobility of the town. Although, the town castle was taken with no any agreement, Durres itself came under Venetian rule by accordance with a preliminary agreement implemented after the death of Gjergj Topia (1392). The sister of the late master, Helena, retreated to Krujë and her husband Mark Barbadiku ruled as a Venetian vassal and later as Ottoman vassal. Over time, the town fell under the rule of the Ottoman vassal Konstantin Balsha and after it passed into Ottoman hands. Not far away in the north, Gjergj Balsha II fell under Ottoman rule and he gave the Ottomans the region of Shkodra in the beginning of 1393, against his release. Albanian ruler, as a vassal of the Ottomans, retreated in Ulqin. His position deteriorated further when Lezha, with the consent of Dukagjini's, passed under Venetian rule. Despite this unenviable position, Gjergj II with his own forces managed to liberate the region of Shkodra from Ottomans (1395). Fearing that the province could fall again under the Ottoman rule, he surrendered it to the Republic of Venice, in exchange of 1 000 dukats per year (1396).

By the end of the 14th century, the patroness of Vlora experienced difficult times in its efforts for existence. Increasingly facing the ottoman threat, she offered her possessions to the Venetian Republic in exchange for a certain annual provision. The Republic rejected her offer and the same position held later toward the new lord of Vlora, Mrksha Zharkovic. On the contrary, Gjirokastra and Arta nobles with joined forces inflicted heavy defeat to the Ottomans, thus maintaining the independence of their possessions.